



ENTER



MANUALI DOGANOR PËR PASAGJERËT

EXIT



dogana.gov.al

Hyrje

Dogana shqiptare, si pjesë e sistemit kombëtar të kontrollit dhe sigurisë, mbetet një ndër institucionet më të rëndësishme në funksion të garantimit të integritetit ekonomik dhe ligjor të vendit. Me Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, politika doganore është gjithnjë e më shumë e orientuar drejt harmonizimit me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së.

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në BE, është e angazhuar të zbatojë një model funksional dhe të besueshëm doganor, në përputhje me rregullat evropiane, për të garantuar:

- mbledhjen efikase dhe transparente të të ardhurave doganore,
- sigurinë e tregut të brendshëm,
- pajtueshmërinë mjedisore të mallrave,
- si dhe për të luftuar tregtinë e paligjshme, mallrat e falsifikuara, e në mënyrë të veçantë, për të mbrojtur prodhimin vendas dhe markën “Made in Albania”.

Po kështu, një rëndësi të veçantë kanë edhe masat për mbrojtjen e specieve të rrezikuara, parandalimin e trafikut të substancave të paligjshme dhe garantimin e një qarkullimi të lirë, por të sigurt të mallrave dhe udhëtarëve në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe “acquis communautaire”.

Kjo veprimtari ndikon drejtpërdrejt edhe në kontrollet që zbatohen ndaj udhëtarëve që hyjnë në Shqipëri apo që largohen drejt vendeve të tjera. Për këtë arsye, është hartuar “Manuali Doganor për Pasagjerët”, i cili përmbledh në mënyrë të qartë e të kuptueshme dispozitat doganore kryesore në fuqi dhe procedurat që zbatohen në pikat kufitare.

Qëllimi është që të gjithë udhëtarët, shqiptarë, apo të huaj, të kenë në dorë një mjet praktik për konsultim të shpejtë, që ndihmon në respektimin e rregullave, në parandalimin e gabimeve të paqëllimta dhe në lehtësimin e kalimit përmes kufirit.

Manuali është i strukturuar në dy pjesë:

1. Për udhëtarët që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. Për udhëtarët që dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë;

Në secilin prej këtyre seksioneve përfshihen informacione që lidhen me zhdoganimin e mallrave personale, produktet e ndaluara, deklarimin e valutës dhe sendeve me vlerë, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbajtjen e kafshëve shtëpiake, si dhe çdo rregull që ndihmon udhëtarët të planifikojnë udhëtimet e tyre në përputhje me ligjin.

Përmbajtja


1. Për udhëtarët që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

- Informacion i përgjithshëm
- Mallrat dhe produktet e konsumit
- Valuta
- Kafshët
- Speciet e mbrojtura
- Pasuritë kulturore
- Armët
- Mjetet e transportit
- Medikamentet
- Mallrat e falsifikuara
- Kontrollet doganore

2. Për udhëtarët që dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë

- Mallrat që merrni me vete kur largoheni
- Eksportimi i produkteve të akcizës
- Mallrat e ndaluara për eksport
- Deklarimi i valutës në dalje
- Kafshët shtëpiake
- Barnat dhe medikamentet
- Rregullat për kalimin kufitar ajror

**PËR UDHËTARËT QË
HYJNË NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**



ENTER

Të gjithë udhëtarët që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes pikave të kalimit kufitar duhet të respektojnë **rregullat doganore në fuqi**, të cilat:

- synojnë të mbrojnë interesat fiskalë të shtetit dhe të sigurojnë mbledhjen e drejtë të detyrimeve doganore;
- garantojnë sigurinë kombëtare dhe shëndetin publik, përmes kontrollit të mallrave të rrezikshme, apo të ndaluara;
- zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare për të cilat Shqipëria është palë, duke harmonizuar sistemin doganor me standardet e Bashkimit Evropian.

Manuali Doganor për Pasagjerët është një udhërrëfyes i përmbledhur për:

- mallrat dhe produktet që lejohen ose ndalohen gjatë hyrjes në Shqipëri;
- **sendet personale** të përjashtuara nga detyrimet;
- **shumat e parave** “cash” që duhet të deklarohen;
- **medikamentet dhe pajisjet mjekësore** që mund të mbahen për përdorim vetjak;
- **kafshët shoqëruese dhe mjetet e transportit** që hyjnë përkohësisht, ose për qëllime afatgjata;
- **pasuritë kulturore, speciet e mbrojtura** dhe mallrat që mbrohen nga legjislacioni ndërkombëtar;
- **ndalesat dhe sanksionet** në rast të shkeljeve të detyrimeve deklaruese.

► **Qëllimi i këtij manuali** është të ndihmojë udhëtarët të shmangin gabimet, të respektojnë detyrimet dhe të kalojnë me lehtësi dhe transparencë përmes pikave doganore shqiptare.

Për çdo paqartësi apo pyetje shtesë, udhëtarët mund të kërkojnë ndihmë nga nëpunësit doganorë në terren, ose të konsultojnë faqen zyrtare:

🌐 **www.dogana.gov.al**

ENTER

Informacion i Përgjithshëm

Administrata Doganore Shqiptare është institucioni përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e lëvizjes së mallrave që hyjnë ose dalin përmes udhëtarëve që kalojnë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë.

Qëllimet dhe detyrat kryesore të saj përfshijnë:

- Zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor në fuqi, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Parandalimin dhe luftimin e kontrabandës, trafikimit të paligjshëm të mallrave, armëve, drogës, valutës, specieve të mbrojtura dhe pasurive kulturore;
- Mbledhjen efikase të të ardhurave doganore, përmes zhdoganimit korrekt dhe të shpejtë;
- Mbështetjen e tregtisë së ligjshme dhe lëvizjen e lirë të udhëtarëve, përmes procedurave të thjeshtuara;
- Sigurimin e transparencës, integritetit dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve dhe operatorëve ekonomikë;
- Përputhjen e plotë të procedurave dhe standardeve me *acquis communautaire*, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Administrata Doganore operon në bashkëpunim me institucione të tjera si **Policia e Shtetit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Banka e Shqipërisë dhe Agjencitë Ndërkombëtare**, për të garantuar një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse në pikat e kalimit kufitar dhe për të rritur sigurinë kombëtare.

Për më shumë informacion, qytetarët mund të konsultojnë burimet zyrtare dhe shërbimet online në faqen:

 **www.dogana.gov.al**



Mallrat dhe Produktet e Konsumit

(Përjashtimet nga detyrimet doganore për udhëtarët që hyjnë në Republikën e Shqipërisë)

Udhëtarët që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të sjellin në bagazhin e tyre mallra që **përjashtohen nga detyrimet doganore**, nëse:

- mallrat janë **për përdorim personal, ose familjar**;
- **nuk kanë karakter tregtar** (nuk janë në sasi të mëdha, nuk janë të njëjta, nuk janë për shitje);
- respektohen kufijtë **vlerorë dhe sasiorë** të përcaktuar në legjislacionin doganor në fuqi.

► Kufijtë vlerorë për përjashtimin nga detyrimet doganore

Kategoria e udhëtarit	Kufiri i vlerës së lejuar pa detyrime doganor
 Udhëtarë me transport ajror, ose detar	Kufiri i vlerës së lejuar do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 430 Euro
 Udhëtarë me mjete tokësore	Kufiri i vlerës së lejuar do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 300 Euro
< 15 Fëmijë nën 15 vjeç	Kufiri i vlerës së lejuar do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 150 Euro

► Nëse vlera e mallrave tejkalon këto kufij, udhëtari është **i detyruar t'i deklarojë mallrat dhe të paguajë detyrimet doganore**.

MALLRAT DHE PRODUKTET E KONSUMIT

► Kufizimet sasiore për mallrat specifike

Në bazë të **Ligjit “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”**, për produktet e akcizës të importuara në bagazhin personal të pasagjerëve, ose përmes mjeteve të transportit ndërkombëtar, zbatohen kufij sasiorë **për konsum personal**, si më poshtë:

Produkti	Sasia e lejuar
Cigare	200 copë
Cigarillo (≤ 3 g)	100 copë
Puro	50 copë
Duham	250 gramë
Alkool i fortë (>22%)	1 litër
Alkool i lehtë (≤22%)	2 litra
Verë	2 litra
Birrë	10 litra
Kafe	3 kg

*Për **produktet e duhanit** (cigare, cigarillo, puro, duhan) dhe për **pijet alkoolike**, lejohet një **kombinim i përzgjedhur në përpjesëtim të drejtë**, pa tejkaluar kufirin total të përcaktuar.

⚠ Udhëtarët nën moshën 17 vjeç nuk përfitojnë nga përjashtimi për produktet e akcizës (duhan dhe alkool).

► Produkte të tjera

Mallrat për përdorim personal si veshje, suvenire, pajisje elektronike me vlerë të kufizuar, artikuj kozmetike, apo ushqimore në sasi jo të mëdha për konsum vetjak lejohen, për sa kohë nuk kalojnë kufijtë e vlerës dhe sasisë dhe nuk duken si mallra për qëllime tregtare.

► Deklarimi dhe procedura

- Deklarimi bëhet vullnetarisht nga udhëtari në pikën doganore hyrëse;
- Nëse doganieri konstaton se mallrat tejkalojnë kriteret, ka të drejtë:
 - të kërkojë pagesën e detyrimeve doganore që mund të përfshijë (TVSH, doganë, akcizë);
 - të kërkojë dokumente për vlerën e mallit;
 - në raste shkeljeje të rëndë, të vendosë gjobë, apo sekuestrim.

Valuta

(Deklarimi i parave “cash” dhe instrumenteve me vlerë monetare)

Udhëtarët që **hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë** janë të detyruar të deklarojnë në doganë:

- **Shuma në të holla** (lekë, euro, dollarë, etj.) çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10000 euro, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera;
- **Qëllimin e mbajtjes së tyre**, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

**Detyrimin për deklaram, sipas pikës 1, të këtij neni e kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë në/ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë me çfarëdolloj mjeti transporti në rrugë tokësore, ajrore ose detare apo dhe nëpërmjet shërbimit postar.*

Kjo kërkesë bazohet në:

- Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar);
- VKM Nr. 480, datë 01.08.2023;

► Kush duhet të deklarojë?

Të gjithë udhëtarët që kalojnë kufirin shqiptar, në hyrje, apo dalje, nëse kanë me vete:

- **Shuma në të holla**;
- Çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, **duke filluar nga shuma 10,000 Euro, ose kundërvlerën e saj** në monedha të tjera;
- **Deklarimi** kryhet pranë zyrave të Administratës Doganore, në Pikën e Kalimit Kufitar, hyrje apo dalje.

Formularët për deklarimin janë të disponueshëm në pikat doganore, si dhe online në faqen zyrtare të Doganës:

🌐 <https://dogana.gov.al/c/174/195/deklarimi-i-parave>

► **Sanksionet për mosdeklarim ose deklarim të pasaktë**

Mosdeklarimi apo deklarimi i rremë përbën **kundërvajtje administrative** dhe në disa raste mund të përbëjë **vepër penale**.

Sanksionet janë si më poshtë:

Shuma e padeklaruar	Gjobë për herën e parë	Gjobë për herën e dytë	Gjobë për rastet e tjera
10,000 € – 19,999 €	20,000 Lekë	10% e shumës së padeklaruar	30% e shumës së padeklaruar
20,000 € – 49,999 €	40,000 Lekë	20% e shumës së padeklaruar	40% e shumës së padeklaruar
> 50,000 €	60,000 Lekë	30% e shumës së padeklaruar	50% e shumës së padeklaruar

⚠️KUJDES!

Udhëtarët duhet të paraqiten pranë Autoriteteve Doganore për të plotësuar **formularin RTVK (Raportim i Transportit të Vlerave në Kufi)** dhe të dorëzojnë dokumente plotësuese që justifikojnë burimin e të ardhurave të deklaruara.

► **Deklarimi i mjeteve monetare**

Udhëtarët duhet të kenë parasysh se **deklarimi kryhet përpara kontrollit të pasaportës nga Policia e Shtetit dhe Autoritetet e Sigurisë**, pavarësisht mënyrës së udhëtimit: *avion, anije, makinë, motor, biçikletë, apo këmbë*.

Kujdes!

- Nuk ka rëndësi ku mbahen vlerat monetare (çantë dore, bagazh, apo mjet udhëtimit).
- Detyrimi për deklarim vlen edhe kur mjetet monetare **nuk janë në pronësinë tuaj**.
- Plotësimi i formularit të deklarimit të vlerave monetare (**RTVK**) është **falas**.

► **Këshilla praktike për udhëtarët:**

- Nëse transportoni **më shumë se 10,000 Euro**, deklarojeni para kontrollit doganor.
- Ruani **dokumentacionin që vërteton burimin e ligjshëm të parave**.

Kafshët

(Qen, mace dhe kafshë të tjera shtëpiake)

Udhëtarët mund të sjellin me vete kafshë shtëpiake në territorin e Republikës së Shqipërisë, vetëm nëse ato **plotësojnë kriteret ligjore dhe shëndetësore** të përcaktuara në legjislacionin shqiptar.

Dispozitat zbatohen në përputhje me:

- **Rregulloren e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB);**
- **Praktikat ndërkombëtare veterinare** për kontrollin e sëmundjeve zoonotike.
- Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011 **“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar,
- Urdhër nr. 353, datë 18.12.2012, Për miratimin e Rregullores **"Mbi kërkesat e shëndetit të kafshëve të zbatuara në lëvizjet jo tregtare të kafshëve të shoqërimit"**.

► Kushtet për hyrjen e kafshëve shtëpiake

Për të hyrë në Shqipëri, kafshët shtëpiake duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

- **Të jenë të identifikuara** (nga një tatuazh i lexueshëm qartësisht, ose nga një sistem identifikimi elektronik, ose nga matrikull)
- Të jenë të shoqëruara nga një pasaportë e lëshuar nga një veteriner zyrtar duke vërtetuar që është kryer vaksina kundër tërbimit dhe kur është e nevojshme, mbi kafshët në fjalë janë kryer masa parandaluese lidhur me sëmundje të tjera
- Lejohet hyrja e kafshëve nën 3 muaj, të pavaksinuara, vetëm nëse:
 - shoqërohen me pasaportë;
 - kanë qëndruar që nga lindja në vendin e origjinës pa kontakt me kafshë të egra, ose shoqërohen nga nëna e tyre.

KAFSHËT

► Kufizime të tjera dhe trajtim në kufi

- Numri maksimal i kafshëve që mund të shoqërojnë një udhëtar është zakonisht deri në 5 kafshë;
- Nëse nuk plotësohen kushtet:
 - hyrja e kafshës mund të ndalohe;
 - kafsha mund të vendoset në karantinë në një qendër të miratuar, deri në përmbushjen e kushteve;
 - ose, në raste të caktuara, mund të urdhërohet kthimi i saj në vendin e origjinës.


! Kafshët pa dokumentacion ose me mashtrime në dokumentacionin shëndetësor trajtohen si rrezik për shëndetin publik dhe për ekosistemin vendas dhe përballen me masa të rrepta sipas ligjit.

► Udhëtimi me kafshë drejt vendeve të tjera

- Për të udhëtuar nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së apo të tjera shteteve, udhëtari duhet të **respektojë kërkesat specifike të vendit pritës**, përfshirë:
 - dokumentacionin veterinar ndërkombëtar,
 - vaksinimet përkatëse,
 - dhe trajtimet e nevojshme paraprake (si për parazitë apo echinococcus multilocularis).

Udhëtarët këshillohen të **konsultohen paraprakisht me ambasadën apo autoritetin veterinar të vendit pritës**.

► Këshilla praktike:



Këshilla	Koha e nevojshme për përgatitje
Aplikimi për pasaportë veterinare	të paktën 2 javë para udhëtimit
Vaksinimi kundër tërbimit	të paktën 21 ditë para hyrjes
Analiza serologjike (nëse kërkohet)	të paktën 3 muaj para hyrjes
Konsultim me autoritetin doganor	para nisjes ose hyrjes

Speciet e Mbrojtura

(Flora, fauna dhe produktet e tyre)

Importi dhe eksporti i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës, përfshirë kafshë të egra, bimë të rralla dhe çdo produkt të derivuar nga to (si fildish, korale, gëzof, lëkurë, preparate etj.), **rregullohet nga Konventa Ndërkombëtare për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër (CITES).**

Shqipëria është palë në këtë konventë, përmes:

- Ligjit nr. 11/2023 për disa ndryshime në ligjin nr.9867, date 31.1.2008, **“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”**, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 105/2016 **Për mbrojtjen e bimëve** (ndryshuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022)
- Akteve nënligjore dhe rregulloreve për zbatimin e saj në territorin shqiptar;
- Përputhjes me legjislacionin për **mbrojtjen e biodiversitetit** dhe **Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë**.

► Çfarë përfshihet?

Në kategorinë e specieve të mbrojtura përfshihen:

Kategoria	Shembuj
Kafshë të egra	<i>papagaj, hardhuca, gjarpërinj, majmunë, krokodilë</i>
Bimë të rralla	<i>orkide, kaktusë, lule të mbrojtura</i>
Produkte të derivuara	<i>fildish, korale, sende dekorative me lëkurë zvarranikësh, gëzof të çmuar</i>
Pjesë bimore, apo shtazore	<i>preparate mjekësore, ushqimore apo kozmetike</i>

SPECIET E MBROJTURA

► Kërkesat për autorizim

Çdo udhëtar që **importon** apo **eksporton** lloje të tilla nga apo drejt Shqipërisë duhet:

- Të pajiset me **autorizim të lëshuar nga autoritetet përkatëse shqiptare** (p.sh. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura – AKZM);
- Të ketë **certifikatën e origjinës ligjore** nga vendi i nisjes;
- Të bëjë **deklarim të detyrueshëm në doganë**, me dokumentacion të plotë.

**Sasi të vogla të bimëve, apo produkteve bimore për qëllime të konsumit vetjak, përdorim personal, përdorim joindustrial, bujqësor, apo tregtar mund të qarkullojnë në vend edhe kur nuk shoqërohen me “Pasaportë bimore”, me kusht që të mos përbëjnë rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm.*

► Produktet që përmbajnë pjesë të specieve të mbrojtura, edhe nëse janë suvenire, apo dhurata, **trajtohen njësoj si eksporte të rregulluara**, nëse ndodhen në listat CITES.

► Ndëshkimet në rast shkeljeje

Nëse udhëtari:

- nuk deklaron mjetin e transportit të specieve të mbrojtura;
- nuk paraqet dokumentacion të vlefshëm CITES;
- apo tenton të importojë/exportojë lloje të ndaluara;

atëherë autoritetet doganore, në bashkëpunim me institucionet mjedisore, zbatojnë këto masa:

- **Sekuestrimin e menjëhershëm të objekteve;**
- **Gjobë administrative**, sipas parashikimeve të Kodit Doganor;
- Në raste të rënda, ndjekje **penale** sipas ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

► Këshilla praktike:

- **Mos udhëtoni me sende me përmbajtje kafshësh ekzotike apo bimore të rralla**, pa u informuar nëse kërkojnë leje CITES;
- Konsultoni databazën ndërkombëtare të specieve të rrezikuara në:

🌐 **www.speciesplus.net**

Pasuritë Kulturore

(Veprat e artit, objektet arkeologjike dhe sendet me vlerë historike)

Dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë e objekteve që përbëjnë pasuri kulturore – si vepra arti, ikona, monedha, gjetje arkeologjike apo objekte të trashëgimisë kombëtare – **lejohet vetëm me autorizim të posaçëm**, në përputhje me:

- **Ligjin nr. 27/2018**, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; (Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024) “;
- Aktet nënligjore përkatëse të **Ministrit të Kulturës** dhe institucioneve të saj të varësisë (p.sh. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore).

► Eksporti i përkohshëm apo përfundimtar

Për çdo dalje nga vendi të objekteve të kësaj natyre (edhe për ekspozita, huazime ose qëllime studimore), kërkohet:

- **Autorizim me shkrim nga autoritetet përkatëse** të kulturës;
- **Deklarim doganor** në dalje, me paraqitjen e dokumentacionit përkatës (vlerësim muzeor, certifikatë pronësie, leje eksporti etj.);
- Në raste të caktuara, **vlerësim i posaçëm nga ekspertë të trashëgimisë**, për të përcaktuar nëse objekti ka vlerë të mbrojtur nga ligji.

! Shkelja e këtyre detyrimeve përbën shkelje të rëndë administrative dhe në disa raste penale, dhe mund të rezultojë në **konfiskimin e objektit** dhe ndjekje ligjore.

► Importi i pasurive kulturore në Shqipëri

Kur objektet me vlerë kulturore futen në territorin shqiptar nga jashtë, strukturat doganore mund të kërkojnë:

- **Verifikimin e prejardhjes së ligjshme të objektit**, përmes dokumentacionit të eksportit (p.sh. leje nga vendi i origjinës);
- **Vlerësim në bashkëpunim me institucionet kulturore**, për të përcaktuar statusin e objektit dhe nëse kërkohet regjistrim si pasuri kombëtare;
- **Mbajtjen në pezullim të objektit** në rast dyshimi për trafikim kulturor, ose origjinë të paligjshme, sipas mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional.

PASURITË KULTURORE

► Disa shembuj të objekteve që kërkojnë autorizim për dalje nga territori shqiptar:

Lloji i Objektit	Autorizimi i nevojshëm
Piktura dhe ikona mbi 50 vjet të vjetra	Po
Artefakte arkeologjike	Po
Monedha dhe medalje antike	Po
Vegla muzikore tradicionale	Po, në disa raste
Vepra arti të autorëve bashkëkohorë	Jo, nëse janë nën 50 vjeç dhe autori është gjallë, kërkohet vetëdeklarim

► **Kujdes:**

- **Shmangia e procedurës së deklarimit dhe autorizimit** trajtohet sipas dispozitave të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe mund të përfshijë hetim për **trafikim të pasurive kulturore**.
- Për udhëtarët që mbajnë me vete sende të trashëguara apo të blera jashtë, **këshillohet të ruajnë faturat dhe dokumentet e prejardhjes** për të shmangur ndalimin në kufi.

Armët

(Armët e zjarrit, armët e ftohta dhe municionet)

Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë me **armë zjarri, armë të ftohta**, apo **municione**, si dhe dalja jashtë tij, **lejohet vetëm në prani të një lejeje të vlefshme**, të lëshuar nga autoritetet përkatëse shqiptare.

Ky rregull bazohet në:

- **Ligjin nr. 74/2014, datë 10.07.2014 “Për armët dhe municionet”;**
- **Udhëzim nr. 368, datë 23.11.2021** Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit, Për pajisjen me Autorizim për armë të subjekteve juridike e fizike, Formatin e regjistrit për armët dhe municionet, Për subjektin e licencuar, Për veprimtaritë me armët, Për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhojës në një bankë të dhënash;
- **VKM nr. 275, datë 01.04.2015** "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë të armëve";
- **Urdhër i MPB nr. 156 datë 01.04.2014** "Për procedurat e komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë";
- **Aktet nënligjore** zbatuese të Policisë së Shtetit dhe Doganës së Shqipërisë;
- Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar për **kontrollin e armëve**.

► Lejimi dhe autorizimet e nevojshme

- Udhëtari duhet të **paraqesë leje të vlefshme për importin/eksportin e armëve**, të lëshuar nga **Policia e Shtetit**, sipas klasifikimit të armëve në **kategori “B” dhe “C”**;
- Leja është **emërore dhe e kufizuar në kohë**, nuk mund të transferohet te persona të tjerë;
- Udhëtari **duhet ta deklarojë armën dhe municionin në pikën doganore** dhe të paraqesë dokumentacionin shoqërues.

ARMËT

► Masa në mungesë të lejes

Nëse udhëtari:

- hyn ose del nga territori pa leje për armë, apo municion,
- ka me vete armë me **markim të fshirë ose pa numër serial**,
- nuk paraqet dokumentacionin e detyrueshëm,

atëherë autoritetet doganore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, kanë të drejtë të:

- **konfiskojnë menjëherë armën dhe municionin;**
- **nisin procedim për kundërvajtje** ose, në raste të rënda, **për ndjekje penale;**
- **njoftojnë autoritetet e vendit të origjinës** për verifikime të mëtejshme ndërkombëtare.

► Regjistrimi dhe identifikimi

Çdo armë që hyn **përfundimisht** në territorin e Shqipërisë për qëllime personale, sportive ose koleksionimi:

- duhet të **regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Armëve** pranë Policisë së Shtetit;
- duhet të **pajiset me vulën zyrtare identifikuese:**

AL + viti i hyrjes

(p.sh. AL2025 për armët e regjistruara këtë vit.)

▲ Kujdes

- **Armët luftarake, automatike ose të ndaluara me ligj nuk lejohen**, përveç rasteve të importit institucional, sipas procedurave ndërqeveritare.
- Udhëtarët që mbajnë armë për **qëllime sportive (gjueti, gara, etj.)** duhet të paraqesin edhe **leje ndërkombëtare të përdoruesit të armës dhe ftesë nga subjekti pritës në Shqipëri**, nëse është e aplikueshme.

❗ Për më shumë informacion:

- Konsultohuni me Policinë e Shtetit:

🌐 **www.asp.gov.al**

- Ose me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

🌐 **www.dogana.gov.al**

Mjetet e Transportit

Importi dhe përdorimi i përkohshëm i mjeteve të transportit në territorin e Republikës së Shqipërisë është i rregulluar nga Kodi Doganor dhe VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

► Përdorimi i përkohshëm i mjeteve (për udhëtarët jorezidentë)

Mjetet që përdoren për **qëllime personale** mund të futen përkohësisht në territorin shqiptar:

- **për një periudhë deri në 6 muaj**, brenda një viti kalendarik;
- **pa pagesë detyrimesh doganore**, nëse:
 - udhëtari **nuk është rezident në Shqipëri**;
 - automjeti **nuk përdoret për qëllime tregtare**, apo me pagesë;
 - automjeti **nuk qëndron në vend më shumë se afati i lejuar**;
 - drejtuesi ka **dokumentacion të plotë** të regjistrimit të mjetit jashtë Shqipërisë.

⚠ Mjetet e përdorura përkohësisht nuk mund të transferohen, shiten apo dhurohen gjatë qëndrimit në Shqipëri, përveçse pas zhdoganimit të tyre të plotë, sipas procedurës së importit të përhershëm.

► Importimi i përhershëm i automjeteve

Nëse udhëtari dëshiron të sjellë automjetin për përdorim të përhershëm në Shqipëri, zbatohet procedura e zakonshme e **importit me pagesë të detyrimeve doganore**.

- Detyrimet përfshijnë: TVSH, taksë doganore, sipas kategorisë së mjetit.
- Vlerësimi bazohet në:
 - vlerën reale të tregut të automjetit;
 - cilësitë teknike: cilindrata, fuqia motorike, data e prodhimit, standardi i ndotjes etj.;
 - origjina dhe dokumentacioni i vlefshëm për certifikimin e tij.

- Për të llogaritur paraprakisht detyrimet doganore të një automjeti, qytetarët mund të përdorin **kalkulatorin doganor online** në faqen zyrtare të Doganës Shqiptare:

🌐 <https://www.dogana.gov.al>

MJETET E TRANSPORTIT

► Dokumentet që kërkohen zakonisht për hyrjen ose importin e një automjeti:

1. Leje qarkullimi dhe certifikata e regjistrimit
2. Polica e sigurimit të automjetit (e vlefshme për Shqipëri)
3. Pasaporta ose ID e drejtuesit
4. Autorizim i posaçëm në rast përdorimi nga person tjetër
5. Faturë ose kontratë blerjeje për import të përhershëm
6. Certifikatë për normën e emetimit (Euro 4, 5, 6 etj.)

◆ Në rast shkeljeje:

- **Qëndrimi i tejzgjatur i mjetit** përtej afatit të autorizuar, pa justifikim dhe pa kërkesë për zgjatje, sjell:
 - Detyrimin për **zhdoganim të detyrueshëm** të mjetit;
 - **Gjobë administrative** sipas Kodit Doganor;
 - Në disa raste, **konfiskim të mjetit** nga autoritetet doganore.

Barnat dhe Medikamentet

Udhëtarët mund të marrin me vete barna për **përdorim personal**, sipas rregullave të mëposhtme:

- Lejohet hyrja në Shqipëri e barnave që nuk përdoren për **qëllim tregtimi ose promovimi**;
- Udhëtari duhet të dorëzojë një **deklaratë me shkrim** pranë Autoriteteve Doganore, ku:
 - Përcaktohet se barnat janë për **përdorim personal**;
 - Jepen kontaktet e mjekut që ka përshkruar trajtimin ose të tregohet që trajtimi ka nisur në një shtet të huaj;
- Sasia e barnave të sjella për trajtimin e individit duhet të jetë e tillë që të përfshijë trajtimin e pacientit për një periudhë **jo më shumë se 2 muaj**, e justifikuar me recetën shoqëruese të mjekut, ku përcaktohet doza ditore e barit për trajtim.
- Për shtetasit me qëndrim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sasia e barit që duhet të mbajë një person me vete duhet të jetë **në përputhje me kohën e qëndrimit të tij në Shqipëri**.
 - Personat në mjekim, të cilët janë në udhëtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, lejohen të mbajnë për përdorim personal barna që përmbajnë lëndë psikotrope të tabelës II dhe III në sasi që **nuk i kalon 7 ditë mjekimi** për barnat e tabelës II dhe **30 ditë mjekimi** për barnat e tabelës III. Këta të sëmurë duhet të kenë me vete kopje të recetave mjekësore përkatëse.

► Për barna që kërkojnë **recetë**, duhet të kenë recetën **në shqip dhe anglisht**, e firmosur dhe vulosur nga mjeku përkatës.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, Neni 13, pika ë)
- VKM nr. 415, datë 13.05.2015 “Për përdorimin e barnave për konsum minimal nga udhëtarët”
- Ligji nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, neni 78 dhe tabelat shoqëruese.

Mallrat e Falsifikuara

Importi apo eksporti i mallrave të falsifikuara është **rreptësisht i ndaluar** në territorin e Shqipërisë. Këto mallra përfshijnë produkte që imitojnë në mënyrë të paligjshme markat tregtare të regjistruara, dizajnet industriale, ose patentat e mbrojtura.

Në zbatim të **Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë** dhe **legjislacionit për mbrojtjen e pronësisë intelektuale**, autoritetet doganore janë të autorizuar të ndalojnë, të sekuestrojnë dhe të asgjësojnë çdo mall që dyshohet se **shkel të drejtat ekskluzive të pronarëve të markave tregtare ose patentave**.

Personat që përpiqen të importojnë ose eksportojnë mallra të falsifikuara mund të përballen me **gjoba administrative, konfiskim të mallit, dhe ndjekje penale**, varësisht nga rrethanat dhe qëllimi i sjelljes së mallit në vend.

Kontrollet Doganore

Të gjithë udhëtarët që **hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë** mund të kontrollohen nga autoritetet doganore. **Kontrollet doganore janë pjesë e masave të sigurisë dhe zbatimit të ligjit**, dhe zbatohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.


Këto kontrole mund të jenë:

- **Të rastësishme**, në bazë të zgjedhjes së automatizuar;
- **Të bazuara në analiza risku**, të cilat marrin parasysh faktorë si itinerari i udhëtimit, sjellja e udhëtarit, apo informacione të tjera operative.

Kontrollet mund të përfshijnë:

- Inspektim fizik të bagazheve;
- Kontroll të dokumenteve identifikuese dhe udhëtimit;
- Verifikim të saktësisë së deklarimeve të bëra nga udhëtari.

Mosdeklarimi i mallrave, ose deklarimi i rremë, përbëjnë **kundërvajtje administrative** ose në disa raste **vepra penale**, të cilat mund të çojnë në **gjobë, konfiskim të mallit dhe procedura të mëtejshme ligjore**, sipas **Kodit Doganor** dhe legjislacionit penal në fuqi.



EXIT

**PËR UDHËTARËT QË
DALIN NGA TERRITORI
I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Rregulla doganore për dalje nga territori shqiptar

Ky seksion përfshin informacionet thelbësore për udhëtarët që largohen nga Shqipëria, në drejtim të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, ose jashtë tij, në lidhje me mallrat që lejohen të merren me vete, kufizimet dhe detyrimet doganore.

► Mallrat që merrni me vete drejt vendeve të BE-së

Nëse jeni duke udhëtuar drejt një vendi të Bashkimit Evropian nga brenda BE, **nuk zbatohen formalitete doganore në hyrje**, për sa kohë mallrat janë:

- **për përdorim personal dhe jo për qëllime tregtare**,
- dhe nuk tejkalojnë kufijtë sasiore indikativë për produkte akcize, të vendosura nga vendi pritës.

► Mallrat që merrni drejt vendeve jashtë BE-së

Kur udhëtoni nga Shqipëria drejt një vendi që **nuk është pjesë e BE-së**, ju këshillohet që të:

- **verifikoni paraprakisht rregullat doganore të vendit të destinacionit**, pasi çdo shtet ka politika të ndryshme për sasinë dhe llojet e mallrave të lejuara;
- **mbani dokumentacionin për mallrat me vlerë** që merrni me vete (faturë, certifikatë garancie);
- bëni **deklarim në doganën shqiptare** për mallrat që mund të ngjallin dyshim në kthim (p.sh., pajisje elektronike).

► Eksportimi i produkteve të akcizës

Në rast se udhëtari merr sasi të konsiderueshme të produkteve të akcizës (duhan, alkool), duhet të ketë parasysh:

- Mund të ndalohen ose konfiskohen nga autoritetet doganore në vendin pritës, nëse tejkalojnë kufijtë e përcaktuar për përdorim personal;
- Çdo **eksport për qëllime tregtare** kërkon dokumentacion të veçantë eksporti dhe licenca tregtare.

EXIT

► Mallrat e ndaluara për eksport

Është e ndaluar të nxirren nga territori i Republikës së Shqipërisë, pa leje përkatëse:

- **Objekte të trashëgimisë kulturore** (ikona, monedha antike, artefakte, vepra arti etj.);
- **Specie të mbrojtura ose produkte të tyre** (fildish, korale, kafshë ekzotike, bimë të rralla);
- **Armë, municione dhe mjete të rrezikshme**, përveç rasteve me autorizim të posaçëm;
- **Mallra të falsifikuara**, të cilat ndalohen rreptësisht në eksport dhe import.

► Deklarimi i valutës në dalje

Mund të merrni me vete çdo sasi deri në **10,000 Euro** pa deklaram; Për çdo shumë nga 10 mijë Euro dhe më të madhe, **duhet të plotësoni një deklaratë zyrtare** pranë zyrës doganore në kufi;

Mosdeklarimi mund të çojë në:

- sekuestrim të shumës së padeklaruar;
- gjoba dhe procedura administrative sipas legjislacionit doganor në vendin e destinacionit.

► Kafshët shtëpiake

Nëse udhëtari udhëton me kafshë shtëpiake (qen, mace, nuselalë), duhet të ketë:

- **pasaportë veterinare të lëshuar nga veterineri i licencuar;**
- **vaksinë kundër tërbimit**, të bërë të paktën 21 ditë para udhëtimit;
- për disa shtete si Irlanda, Malta dhe Finlanda, kërkohet **trajtim kundër echinococcus multilocularis**.

Kafsha duhet të jetë e identifikuar me **mikroçip** dhe mundësisht jo më e vogël se **3 muajsh**.

► Barnat dhe medikamentet

- Udhëtarët mund të marrin me vete barna për **përdorim personal**, për periudhë jo më shumë se 2 muaj, e justifikuar me recetën shoqëruese të mjekut, ku përcaktohet doza ditore e barit për trajtim për periudhën e udhëtimit.
- Për barna që kërkojnë recetë, është e nevojshme të kenë **recetë mjekësore në shqip dhe anglisht**, e firmosur dhe vulosur nga mjeku përkatës.

RREGULLA DOGANORE PËR DALJE NGA TERRITORI SHQIPTAR

► Rregullat për kalimin kufitar ajror

- **Kontroli i bagazheve** bëhet në aeroportin e nisjes nga Shqipëria;
- Në rast udhëtimesh tranzit përmes një vendi të BE-së, është e mundur që **kontrollet për bagazhin e dorës** të kryhen në pikën e tranzitit;
- Në shumë raste, kontrollet doganore për mallra të ndjeshme bëhen **në vendin e parë të mbërritjes në BE**.

⚠ **Kujdes:**

- **Rregullat doganore ndryshojnë** nga një shtet në tjetrin! Udhëtarët këshillohen të informohen paraprakisht pranë ambasadës, apo doganës së vendit të destinacionit;
- Mallrat që tejkalojnë sasinë, apo vlerën e lejuar, mund të **konfiskohen**, ose të ngarkohen me **taksat përkatëse në kufi**.



MANUALI DOGANOR PËR PASAGJERËT

